



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 dhjetor 2017
Nr. Ref.: RK 1173/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI106/17

Parashtrues

Qerim Begolli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP nr. 41/2017,
të 19 korrikut 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Qerim Begolli nga Peja (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (ARJ-UZVP nr. 41/2017, të 19 korrikut 2017), me të cilin ishte refuzuar kërkesa e parashtruesit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të refuzimit të kërkesës së tij për masë të sigurisë pas procedurës në të cilën ai kërkoi anulimin e Vendimit (nr. 47/2017, të 6 marsit 2017) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KGJK).
3. Aktgjykimi i kontestuar iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 12 gusht 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta). Parashtruesi gjithashtu pretendon shkelje të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
5. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, kërkon nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht *“të pezulloj dekretimin e gjyqtarëve të përzgjedhur sipas konkursit për rekrutimin e gjyqtarëve për Gjykata Themelore të Kosovës [...]”*.
6. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të mbajë një dëgjim publik *“me qëllim të qartësimit të provave të prezantuar, në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës.”*

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenet 27 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullat 54 dhe 56 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 30 gusht 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
9. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodriguez (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
10. Më 6 shtator 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
11. Më 18 shtator 2017, parashtruesi parashtroi një letër shtesë në Gjykatë.

12. Më 13 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në prill të vitit 2016, KGJK-ja shpalli konkurs për 61 gjyqtarë të rinj që do të emëroheshin në nivelin e gjykatave themelore në Kosovë. Parashtruesi i kërkesës ishte një nga kandidatët që konkurronin për një pozitë. Në testin kualifikues, parashtruesi i kërkesës kishte grumbulluar më pak se 45 pikë.
14. Më 6 mars 2017, KGJK-ja (Vendimi nr. 47/2017) vendosi si në vijim:
- “1. Anulohet vendimi i KGJK-së nr. 131/2016, për uljen e pragut të kalueshmërisë i datës 28 tetor 2016.*
- 2. Anulohen rezultatet e provimit me shkrim të datës 3 dhe 4 dhjetor 2016, për të gjithë kandidatët që kanë aplikuar në pozitën gjyqtar në gjykatat Themelore.*
- 3. Të përsëritet provimi me shkrim vetëm për 75 kandidatët, të cilët në testin kualifikues, të datës 15 tetor 2016, kanë arritur të sigurojnë 45 apo me shumë pikë.”*
15. Më 22 mars 2017, parashtruesi parashtroi padi kundër KGJK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë, duke kërkuar anulimin e vendimit të lartpërmendur. Përveç kësaj, parashtruesi kërkoi që të miratohej një masë e përkohshme [masa e sigurisë] përmes së cilës KGJK-ja do të urdhërohej që ta ndalojë procedurën e emërimit për gjyqtarët e rinj derisa meritat e padisë së tij të trajtohen nga gjykatat e rregullta.
16. Më 24 mars 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë [mungon numri i Aktvendimit] e ftoi parashtruesin ta rishikonte padinë e tij *“konform dispozitave në fuqi me të cilat rregullohet çështja e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ”*.
17. Më 3 prill 2017, parashtruesi i kërkesës konfirmoi qëndrimin e tij të deklaruar në padinë e tij fillestare. Ai pretendoi se Gjykata Themelore në Prishtinë duhet t'i aprovojë atij masën e përkohshme në pajtim me *“nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 306 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore”*.
18. Më 4 prill 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë (Aktvendimi A. nr. 524/17) e hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit për masë të përkohshme si të palejueshme me ligj, duke arsyetuar se: *“[...] propozimi i paditësve si i tillë përmban të meta të cilat pamundësojnë zhvillimin e procedurës sa i përket këtij propozimi, ndërsa të njëjtit [parashtruesi(t) e kërkesës] nuk i kanë mënjeluar ato as pas obligimit nga ana e gjykatës, me udhëzime konkrete.”*
19. Parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë pranë Gjykatës së Apelit. Ai e kontestoi ligjshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar se Ligji për Konfliktet Administrative dhe Ligji për Procedurën Kontestimore nuk ishin zbatuar në mënyrë të drejtë.

20. Më 25 maj 2017, Gjykata e Apelit (Aktvendimi AA. nr. 163/2017) e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe kështu vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Gjykata e Apelit, *inter alia*, e arsyetoi që:

“Kolegji i Apelit, njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se propozimi i paditësve [...] nuk është i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 22 të Ligjit për Konflikte Administrative, i cili e rregullon mënyrën e parashtrimit të kërkesës për shtyrjen e vendimit përfundimtar të organit administrativ deri në vendosjen meritorë të çështjes sipas padisë. [...] Nga gjykata e shkallës së parë u është kthyer propozimi për plotësimin dhe korrigjimin që të njëjtën ta ushtrojnë si në vështrim të nenit 22 të Ligjit Për Konflikte Administrative, por prapë propozuesit kanë vepruar në mënyrë të njëjtë, duke kërkuar masën e përkohshme të sigurimit, e po ashtu edhe në ankesë, por në procedurë të konfliktit administrativ nuk zbatohet ky institut [...] andaj, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e hudhë si të palejueshëm propozimin e paditësve për shkak të metave ligjore dhe mos mënjanimit të tyre me plotësimin dhe korrigjimin [...].”

21. Kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm pranë Gjykatës Supreme, duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale dhe procedurale.
22. Më 19 korrik 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykimi ARJ-UZVP nr. 41/2017) e refuzoi kërkesën e parashtruesit si të pabazuar. Gjykata Supreme konsideroi se gjykatat më të ulëta kishin zbatuar drejtë ligjin material dhe kështu vërtetuan vendimet e tyre. Në pjesën përkatëse të aktgjykimit thuhet:

“[...] gjykata e shkallës së dytë ka bërë aplikimin e drejtë, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësve [...]. Neni 63 i Ligjit për Konflikte Administrative parashikon se nëse ky Ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktin administrativ, do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore . [...] Në rastin konkret, sipas interpretimit të drejtë, është dashtë që paditësit të kërkojnë nga gjykata e shkallës së parë shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, si në vështrim të nenit 22.6 LKA, e jo të nenit 306 të Ligjit për Procedurën Kontestimore [...], sepse neni 63 (LKA) zbatohet vetëm nëse ky ligj (LKA) nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktin administrativ.”

Argumentet ligjore të paraqitura nga parashtruesi i kërkesës

23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] i Kushtetutës si dhe e drejta e tij e garantuar me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.
24. Lidhur me të drejtën e tij për “barazi para ligjit” dhe të drejtën për “punë dhe ushtrim të profesioneve”, parashtruesi i kërkesës pretendon se duke mos shqiptuar masën e përkohshme dhe duke mos shqyrtuar provat që ai ka

paraqitur, gjykatat themelore “i kanë shkaktuar dëm të pariparueshëm” dhe nuk i kanë ofruar trajtim të barabartë me “kandidatët tjerë”.

25. Sa i përket të drejtës së tij për “gjykim të drejtë dhe të paanshëm”, parashtruesi i kërkesës më tej pohon se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ishte “i njëanshëm për shkak se gjatë vendosjes lidhur me ankesën [...] Kryetari i Kolegjit të Gjykatës Supreme ka qenë gjyqtari N.B. (në kohën e shpalljes së konkursit, anëtar i komisionit për pranimin e kandidatëve për gjyqtarë).” Sipas parashtruesit të kërkesës, gjyqtari N.B. “është dashtë të kërkon përjashtimin e vet” nga rasti i tij.
26. Parashtruesi i kërkesës përfundon, duke kërkuar nga Gjykata si më poshtë:

“[...] kërkoj që Gjykata Kushtetuese e Kosovës, të shpallë të pavlefshëm aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, ARJ-UZVP. nr. 41/2017 të dt.19.07.2017, të vendos masën e përkohshme të sigurimit ashtu si është kërkuar me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit në kërkesëpadinë e parashtruar me datë 22.03.2017, të pezulloj dekretimin e gjyqtarëve të përzgjedhur sipas konkursit për rekrutimin e gjyqtarëve për Gjykata Themelore të Kosovës i shpallur me datë 24.04.2016, për shkak të shkeljeve të pretenduara të Kushtetutës.”

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të parapara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, neni 113 i Kushtetutës përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
[...]*

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

29. Përveç kësaj, neni 49 i Ligjit parasheh: “Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”.
30. Në rastin konkret, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion duke pasur parasysh se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme mund të kontestohet vetëm në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesit i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar më 12 gusht 2017, dhe ai e ka parashtruar kërkesën e tij në Gjykatë më 30 gusht 2017.

31. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i janë dhënë atij me ligjin e zbatueshëm dhe se kërkesa është dorëzuar brenda afatit prej 4 (katër) muajsh.
32. Megjithatë, Gjykata gjithashtu duhet të marrë parasysh nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës.

Neni 48 i Ligjit

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Rregulli 36 i Rregullores së punës

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse: [...] (d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...], ose

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

d) Parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

33. Parashtruesi i kërkesës, siç u theksua më lart, e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (ARJ-UZVP nr. 41/2017, të 19 korrikut 2017), duke pretenduar shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, barazi para ligjit dhe të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, siç mbrohet me Kushtetutë, gjegjësisht me Konventë.
34. Në lidhje me të drejtën e tij të mbrojtur me nenet 24 dhe 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk i kanë shqyrtuar provat e paraqitura prej tij që krijuan një situatë të “*dëmit të pariparueshëm*”. Ai më tej pohon se gjykatat e rregullta e kanë vendosur atë në pozitë të pabarabartë me kandidatët e tjerë.
35. Në dritën e këtyre pretendimeve, Gjykata së pari rikujton se kërkesa e parashtruesit ishte refuzuar në pikëpamje procedurale, pasi që ishte konsideruar si “*e palejueshme me ligj*”. Edhe pas një kërkesë specifike nga Gjykata Themelore në Prishtinë për korrigjimin dhe harmonizimin e padisë në pajtim me ligjin në fuqi, parashtruesi i kërkesës konfirmoi padinë e tij fillestare dhe nuk e korrigjoi atë sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së parë. Kjo e fundit arsyetoi vendimin e saj për këtë çështje, duke iu referuar ligjit material përkatës.
36. Më tej, lidhur me këtë çështje vendimtare, Gjykata rikujton që parashtruesi parashtroi padinë e tij të parë dhe padinë e tij të rishikuar, pjesërisht të bazuar në dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe pjesërisht në Ligjin për

Konfliktet Administrative. Megjithatë, gjykatat e rregullta i shpjeguan parashtruesit se një kërkesë mund të paraqitet në bazë të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore vetëm atëherë kur Ligji për Konfliktet Administrative nuk i rregullon vetë këto çështje. Duke pasur parasysh se Ligji për Konfliktet Administrative rregullon çështjen e “shtyrjes së ekzekutimit të një akti administrativ”, parashtruesi u ftua për të korrigjuar padinë e tij në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Pavarësisht nga kjo, vendimet e gjykatave të rregullta tregojnë se parashtruesi i kërkesës e kishte bazuar përsëri padinë e tij në dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, e cila më pas u konsiderua si padi e palejueshme sipas ligjit nga gjykatat e rregullta.

37. Gjykata po ashtu rikujton se qëndrimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me palejueshmërinë e padisë së parashtruesit u vërtetua plotësisht nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme. Gjykata e Apelit konsideronte se pretendimi i parashtruesit nuk ishte “bazuar në dispozitat ligjore të nenit 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative”; ndërsa Gjykata Supreme konfirmoi se parashtruesi duhet të kërkonte shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ [Vendimit (nr. 47/2017 i 6 marsit 2017) të KGJK-së], në pajtim me “nenin 22.6 të Ligjit për Konfliktin Administrativ dhe jo nenin 306 të Ligjit për Procedurën Kontestimore”.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga autoritetet publike, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
39. Gjykata Kushtetuese gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta apo autoritetet tjera publike. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih: *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, para. 28; shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI70/11 parashtruesit e kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të shumta për të paraqitur rastin e tij në gjykatat e rregullta. Çështja e ligjit të zbatueshëm është adresuar gjerësisht nga të gjitha gjykatat e rregullta. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme i janë përgjigjur pretendimit të parashtruesit se pse padia e tij është konsideruar e palejueshme me ligj.
41. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi janë mbajtur në mënyrë të tillë, saqë parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991). Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk i jep të drejtë të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ.
42. Gjykata konsideron se procedurat në Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (shih,

mutatis mutandis, Shub kundër Lituanisë, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).

43. Në lidhje me të drejtën e tij të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme nuk ka qenë e paanshme, duke pasur parasysh se një nga gjyqtarët e Gjykatës Supreme që ka vendosur për kërkesën e tij për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ka qenë *“anëtar i komisionit për pranimin e kandidatëve për gjyqtarë.”* Sipas parashtruesit të kërkesës, gjyqtari N.B. *“është dashtë të kërkon përjashtimin e vet”* nga rasti i tij.
44. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se përkundër pretendimit për paanshmëri të një gjyqtari të caktuar të Gjykatës Supreme, parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë fakt për të dëshmuar thëniet e tij. Ai nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që tregon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të mbrojtur me Kushtetutë dhe Konventë (shih *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk specifikon se si nenet e referuara të Kushtetutës dhe Konventës mbështesin pretendimin e tij, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës.
45. Fakti i thjeshtë se një gjyqtar ishte pjesë e një komisioni të caktuar nuk e diskualifikon automatikisht atë që të ulet në bankën e gjyqtarit. Barra e provës rëndon te parashtruesi i kërkesës për të bindur këtë Gjykatë se si dhe pse duhet ta vë në dyshim paanësinë e gjyqtarit. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar asnjë dëshmi apo argumente në këtë drejtim dhe si rrjedhojë, Gjykata nuk gjen arsye për të vendosur që paanshmëria e gjyqtarit ngre ndonjë shqetësim që mund të dërgonte në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
46. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe garancitë e shqyrtuara më lart, Gjykata gjen se ankesat e parashtruesit të kërkesës për paanshmërinë e gjyqtarit N.B. nuk arsyetohen dhe nuk dëshmohen në mënyrë objektive.
47. Si përmbledhje, pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë janë të pabazuara në baza kushtetuese dhe nuk janë dëshmuar dhe prandaj janë qartazi të pabazuara.
48. Për arsyet e mësipërme, Gjykata konsideron se, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, kërkesa është e papranueshme.

Kërkesa për seancë dëgjimore

49. Parashtruesi gjithashtu kërkoi që Gjykata të mbajë seancë dëgjimore *“me qëllim të qartësimit të provave të prezantuara, në pajtim me rregullin 39 të Rregullores së punës.”*
50. Gjykata rikujton se, në pajtim me rregullin 39 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë], *“Vetëm kërkesat e përcaktuara si të pranueshme mund të dëgjohen para Gjykatës [...]”*

51. Gjykata ka konkluduar se kërkesa është e papranueshme prandaj nuk ka nevojë të mbahet seancë dëgjimore.

Kërkesa për masë të përkohshme

52. Parashtruesi kërkoi nga Gjykata që të vendosë masë të përkohshme, përkatësisht të shtyjë emërimin e gjyqtarëve të zgjedhur pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes nga KGJK-ja për gjyqtarë të Gjykatës Themelore.
53. Parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar ndonjë argument ose arsye se pse masa e përkohshme duhet të miratohet nga Gjykata. Ai thjesht e përmendi atë në pjesën përmbyllëse të kërkesës së tij, pa dhënë ndonjë arsye ose argument bindës.
54. Në mënyrë që Gjykata të vendosë për masë të përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, është e nevojshme që:

“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar rastin prima facie për meritat e kërkesës dhe, nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;

(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe
[...]

Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës.”

55. Siç u theksua më lart, parashtruesi nuk ka treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Prandaj, Gjykata e refuzon kërkesën për masë të përkohshme si të pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (2) (b) dhe (d), 39, 55 (4) dhe 56 (3) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 13 nëntor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi